



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 1197/1 Prot.

Vlorë më, 01.09. 2022

VENDIM

Nr. 14, datë 31. 08. 2022

PËR

MIRATIMIN E AFATIT TË APLIKIMIT TË SHTETASVE TË HUAJ NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PROGRAMET ME KARAKTER PROFESIONAL SI
EDHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të udhëzimit Nr. 10 datë 15.05.2022 " Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e Arsimit të Lartë, ndryshuar me udhëzimin Nr.16, datë 29.06.2022 "Për regjistrimet në vitin akademik 2022-2023", Kreu IV/3, pika 1,Rektorati, në mbledhjen e datës 31. 08 .2022

VENDOSI:

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në Programet e Ciklit të Parë, në programet me karakter profesional, në programe të integruara të Ciklit të Dytë, duhet të aplikojnë pranë Sekretarive përkatëse të Fakulteteve nga datat 2 shtator 2022 deri më 13 shtator 2022.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për pasqyrimin në Website e UV të këtij vendimi në gjuhën shqipe dhe angleze si edhe sekretaritetë e Fakulteteve për kryerjen e procedurës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. ~~DE~~ ROLAND ZISI

